




KOMUNA E DEÇANIT

Municipality of Deçan

Opština Dečan



RAPORTI NJË VJEÇAR I PUNËS 2023



BASHKIM RAMOSAJ
KRYETAR I KOMUNËS SË DEÇANIT

Qytetarë të dashur të Komunës së Deçanit,

Si rezultat i punëve dhe angazhimit gjatë vitit 2023, në shërbim të qytetit dhe të fshatrave të Komunës së Deçanit, po ju prezantojmë raportin e punëve dhe projekteve të përmbyllura, të atyre që janë në stade të ndryshme të zhvillimit, si dhe të planifikimit.

Raporti pasqyron të gjitha aktivitetet dhe angazhimet e Drejtorive Komunale në Komunën e Deçanit, si dhe të njësive të cilat veprojnë në kuadër të Zyrës së Kryetarit, njëkohësisht reflekton angazhimin dhe rezultatet e shënuara në këtë periudhë.

Jemi angazhuar fuqishëm që të arrijmë nivel më të lartë të transparencës komunale dhe në vazhdimësi jemi përkujdesur që praktikat më të avancuara demokratike, të aplikohen gjatë vendimmarrjes në Qeverinë Komunale. Komunikimi i përhershëm me qytetarë, subjekte dhe institucione vendore e ndërkombëtare, shënojnë bazën e ndërtimit të proceseve vendimmarrëse dhe të avancimit të performancës në menaxhim të organeve komunale. Premtoj, se do të jem përgjegjës çdo ditë para jush dhe qytetarëve të Komunës së Deçanit, duke raportuar dhe duke marr për bazë kërkesat dhe rekomandimet tuaja!

Sinqerisht,
Bashkim Ramosaj

PËRMBAJTJA

Hyrje	4
ZYRA E KRYETARIT	4
Zyra për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun	7
Zyra e Prokurimit	12
Zyra e Auditorit të Brendshëm	17
Zyra e Personelit	20
Zyra për Komunitete dhe Kthim	46
DREJTORIA E ADMINISTRATËS	51
DREJTORIA PËR URBANIZËM, PLANIFIKIM HAPËSINOR DHE MBROJTJE TË MJEDISIT	53
DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA	78
DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE	93
DREJTORIA PËR ARSIM	118
DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL	129
DREJTORIA PËR MBROJTJE, SHPËTIM DHE SHËRBIME PUBLIKE	134
DREJTORIA PËR INSPEKSION	149
DREJTORIA PËR EKONOMI DHE ZHVILLIM	151
DREJTORIA PËR GJEODEZI DHE KADASTËR	161
DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT.....	163

Hyrje

Bazuar në Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe Statutin e Komunës së Deçanit i datës 31.10.2019, si dhe në Planin e Punës së Kryetarit dhe Qeverisë Komunale 2023, paraqesim raportin vjetor të punës për periudhën Janar - Dhjetor 2023.

Raporti pasqyron rezultatet e arritura, aktivitetet dhe angazhimet e Drejtorive Komunale të Komunës së Deçanit si dhe njësive të cilat veprojnë në kuadër të zyrës së kryetarit gjatë periudhës raportuese Janar – Dhjetor 2023.

Zyra e kryetarit gjatë kësaj periudhe është angazhuar maksimalisht për organizimin sa më të mirë të të gjitha aktiviteteve të organizuara nën patronatin e kryetarit të komunës, si dhe organizimin e takimeve të ndryshme.

➤ Zyra e Kryetarit

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2023, Zyra e Kryetarit të Komunës së Deçanit ka kryer këto punë:

- Organizimin e takimeve protokollare të kryetarit të komunës;
- Evidentimin dhe mbikëqyrjen e takimeve të kryetarit të komunës;
- Përgatitjen e takimeve të kryetarit me delegacione të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare, nga niveli qendror dhe lokal;
- Organizimin e takimeve të kryetarit me qytetarët e Komunës së Deçanit;
- Organizimin e dy Takimeve Publike ashtu siç e parasheh Ligji për Vetëqeverisje Lokale;
- Ka pranuar **2,136** lëndë të protokolluara, nga të cilat janë kërkesa, vendime, kontrata, memorandume, marrëveshje, shkresa, njoftime, prej të cilave **9** janë ceduar, **49** janë refuzuar, **2** janë hedhur poshtë, **11** janë anuluar, **3** janë pezulluar dhe **2,062** janë miratuar.

Nga këto kërkesa, **224** prej tyre me vlerë totale prej **197,000.00** euro, **129** prej tyre janë bërë vendime për subvencionim të personave me sëmundje malinje, me kushte jo të mira financiare dhe vendime tjera për mbështetje financiare varësisht nga kërkesa dhe **78** janë ndarë për bursa të studentëve.

Kemi ndarë subvencione në vlerë prej **80.000** eurove për **19** Organizata Joqeveritare dhe Klube Sportive që veprojnë në Komunën e Deçanit, për mbështetje të projekteve të ndryshme.

Kemi nënshkruar **19** Marrëveshje / Memorandume Bashkëpunimi për projekte të ndryshme, si:

- Projekti për përmirësimin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare “Adem Ukëhaxhaj” me Ambasadën e Japonisë në Kosovë;
- Projekti për finalizimin e Qendrës Rinore me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
- Memorandum Mirëkuptimi me Qendrën për Mirëqenien e Gruas;
- Projekti i Rrugës së Qendrës për fazën përfundimtare, Lloti III i rrugëve dhe përfundimi i segmentit të fundit të rrugës së Pleqes me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;
- Projekti “Të Bashkuar për Ajër të Pastër” me OJQ “Let’s Do It Peja”;
- Projekti për vendosjen e këndit të lojërave në shkollën fillore “Bajram Curri” në fshatin Strelle i Epërm, me Organizatën Humanitare “Humanity First”;
- Memorandum Mirëkuptimi rreth zbatimit të brendit rajonal për rajonin ekonomik perëndim, i bazuar në vlerat e përbashkëta të trashëgimisë kulturore me Fondacionin Kosovar Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHwB Kosova);
- Krijimi i Forumit Ekonomik Rajonal “Dukagjini” me Universitetin “Haxhi Zeka”, Pejë;
- Projekti për asfaltimin e rrugës “Arben Qerimaj” në Baballoq dhe rrugës “Veteranët e UÇK-së” në Prapaqan me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal;
- Projekti për ndërtimin e 4 urave në rrugën që të shpie në Roshkodol dhe ndërtimin e parkut në Isniq me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal;
- Memorandum Mirëkuptimi me Fondin për Zhvillim Komunitar – CDF për shtimin e një shtegu të ri në fshatin Belle;
- Marrëveshje me NPL “Higjiena” për mirëmbajtjen e Institucioneve Publike të Komunës së Deçanit;
- Memorandum Mirëkuptimi me Organizatën CELIM për pranimin e dy automjeteve Land Rover Defender 110 për zyrën e turizmit;
- Memorandum Mirëkuptimi me Organizatën Rrjeti i Grave “Qeliza”;
- Marrëveshje me Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave në Tiranë;
- Marrëveshje me K.R.U “Hidrodrini” Sh.A, Pejë;
- Marrëveshje Bashkëpunimi me OZHR “Mëshqerra” për kontingjentin e dytë me lopë qumështore;
- Memorandum Mirëkuptimi me OJQ Green Art Center – GAC, për zhvillimin dhe përmirësimin e sektorit mjedisor dhe turizmit në Komunën e Deçanit;
- Memorandum i Bashkëpunimit për transferimin nga komuna në Agjencinë Pyjore të Kosovës të stafit të pylltarisë, rojeve të pyllit, teknikëve të pylltarisë, përgjegjësive të njësisë komunale etj., me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal;

